

**BAKER TILLY ALBANIA SHPK.**

Pasqyrat Financiare  
Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013

## **PERMBAJTJA:**

<b>PASQYRA E GJENDJES FINANCIARE</b>	<b>3</b>
<b>PASQYRA E TE ARDHURAVE</b>	<b>4</b>
<b>PASQYRA E FLUKSEVE MONETARE</b>	<b>5</b>
<b>PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITAL</b>	<b>6</b>
<b>1. Informacion i pergjithshem</b>	<b>7</b>
<b>2. Bazat e pregatitjes se pasqyrave financiare</b>	<b>7</b>
<b>3. Mjete monetare</b>	<b>10</b>
<b>4. Kliente dhe te tjera kerkesa te arketueshme</b>	<b>10</b>
<b>5. Aktive afatgjata materiale</b>	<b>10</b>
<b>6. Aktive afatgjata jomateriale</b>	<b>11</b>
<b>7. Furnitore dhe detyrime te tjera</b>	<b>11</b>
<b>8. Te drejat dhe detyrime si perfaqesues tatimor</b>	<b>11</b>
<b>9. Te ardhura nga sherbimet</b>	<b>12</b>
<b>10. Shpenzimer per personelin</b>	<b>12</b>
<b>11. Shpenzime administrative dhe te tjera</b>	<b>12</b>
<b>12. Shpenzimi per tatim fitimin</b>	<b>12</b>
<b>13. Parapagim tatim fitimi</b>	<b>13</b>
<b>14. TVSH</b>	<b>13</b>
<b>15. Ngjarje pas mbylljes se vitit ushtrimor</b>	<b>13</b>


## PASQYRA E GJENDJES FINANCIARE


AKTIVET	Shënime	Ne 31 Dhjetor	
		2013 LEK	2012 LEK
Mjete monetare	3	4.481.945	146.699
Kliente dhe të tjera kërkesa të arkëtueshme	4	4.280.602	3.779.983
Kërkesa të arkëtueshme - përfaqësuesi tatimor	8	8.742.864	-
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>		<b>17.505.411</b>	<b>3.926.682</b>
Aktive afatgjata materiale	5	818.322	923.679
Aktive afatgjata jomateriale	6	106.448	138.844
<b>Totali aktiveve afatgjata</b>		<b>924.770</b>	<b>1.062.523</b>
<b>TOTALI AKTIVEVE</b>		<b>18.430.181</b>	<b>4.989.205</b>
<b>Detyrimet dhe Kapitali</b>			
Furnitorë dhe detyrime të tjera	7	5.910.167	3.207.443
Paradhënie të marra – përfaqësuesi tatimor	8	10.913.760	-
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>16.823.927</b>	<b>3.207.443</b>
Kapitali		1.000.000	1.000.000
Rezerva ligjore		184.393	152.953
Fitime të pashpërndara		421.861	628.809
<b>Totali i kapitalit</b>		<b>1.606.254</b>	<b>1.781.762</b>
<b>TOTALI DETYRIMEVE DHE KAPITALIT</b>		<b>18.430.181</b>	<b>4.989.205</b>

Pasqyra e Gjendjes Financiare duhet te lexohet se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 7 – 13 qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare dhe shenimet shpjeguese nga faqja 3 deri 13 jane firmosur dhe miratuar ne 28 Mars 2014 nga:

Elton Haxhi  
Ekspert Kontabel i Regjistruar  
Administrator





**BAKER TILLY ALBANIA**  
SHPK  
K91721010Q

## PASQYRA E TE ARDHURAVE

	Shënime	Per vitin e mbyllur ne 31 Dhjetor	
		2013	2012
		LEK	LEK
<b>TE ARDHURAT</b>			
Te ardhura nga sherbimet	9	15.633.366	14.373.089
<b>Totali i te ardhurave</b>		<b>15.633.366</b>	<b>14.373.089</b>
<b>SHPENZIMET</b>			
Shpenzime per personelin	10	11.142.582	9.928.365
Amortizimi		228.452	260.730
Shpenzime administrative dhe te tjera	11	3.752.406	3.432.179
<b>Totali i shpenzimeve</b>		<b>15.123.440</b>	<b>13.621.274</b>
<b>Fitimi nga veprimtaria kryesore</b>		<b>509.926</b>	<b>751.815</b>
Te ardhura / (Shpenzime) financiare		9.048	(28.702)
<b>Fitimi para tatimit</b>		<b>518.974</b>	<b>723.113</b>
Shpenzimi per tatim fitimin	12	97.113	94.304
<b>FITIMI NETO</b>		<b>421.861</b>	<b>628.809</b>


Pasqyra e te Ardhurave duhet te lexohet se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 7 – 13 qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare



## PASQYRA E FLUKSEVE MONETARE

Shenime	Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor	
	2013	2012
<b>Fluksi monetar nga veprimtarite e shfrytezimit</b>		
Fitimi para tatimit	518.974	723.113
Rregullime per:		
Amortizimin	6, 7 228.452	260.730
<b>Fitimi nga veprimtarite e shfrytezimit para rregullimeve ne kapitalin punues</b>	<b>747.426</b>	<b>983.843</b>
( Rritje)/ Zvogelim ne tepricen e kerkesave te arketueshme	(9.242.671)	(214.067)
Rritje / (Zvogelim) ne tepricen e detyrimeve	13.616.487	(2.014.464)
<b>Fluksi monetar nga veprimtarite e shfrytezimit</b>	<b>5.121.242</b>	<b>(1.244.688)</b>
Tatim fitimi i paguar	(97.924)	(161.480)
<b>Fluksi monetar neto nga veprimtarite e shfrytezimit</b>	<b>5.023.318</b>	<b>(1.406.168)</b>
<b>Fluksi monetar nga veprimtarite e investimit</b>		
Blerje aktive afatgjata materiale	(90.700)	(35.625)
<b>Fluksi monetar neto nga veprimtarite e investimit</b>	<b>(90.700)</b>	<b>(35.625)</b>
<b>Fluksi monetar nga veprimtarite e financimit</b>		
Dividente te paguar	(597.371)	(922.050)
<b>Fluksi monetar neto nga veprimtarite e financimit</b>	<b>(597.371)</b>	<b>(922.050)</b>
Rritja/(zvogelimi) neto i mjeteve monetare	4.335.247	(2.363.843)
Mjete monetare ne fillim te periudhes	4 146.699	2.510.542
<b>Mjete monetare ne fund te periudhes</b>	<b>4 4.481.945</b>	<b>146.699</b>


Pasqyra e flukseve monetare duhet te lexohet se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 7 – 13 qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare



## PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITAL

	Kapitali	Rezerva Ligjore	Fitime te mbartura	Total
<b>Gjendje ne 1 Janar 2012</b>	1.000.000	104.424	970.579	<b>2.075.003</b>
Rezerva ligjore	-	48.529	(48.529)	-
Divident viti 2011	-	-	(922.050)	<b>(922.050)</b>
Fitimi i vitit 2012	-	-	628.809	<b>628.809</b>
<b>Gjendja ne 31 Dhjetor 2012</b>	<b>1.000.000</b>	<b>152.953</b>	<b>628.809</b>	<b>1.781.762</b>
Rezerva ligjore	-	31.440	(31.440)	-
Divident viti 2012	-	-	(597.371)	<b>(597.371)</b>
Fitimi i vitit 2013	-	-	421.861	<b>421.861</b>
<b>Gjendja ne 31 Dhjetor 2013</b>	<b>1.000.000</b>	<b>184.393</b>	<b>421.859</b>	<b>1.606.252</b>

Pasqyra e ndryshimeve ne kapital duhet te lexohet se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 7 – 13 qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare



## **1. INFORMACION I PERGJITHSHEM**

Shoqeria BAKER TILLY ALBANIA shpk. (me poshte ‘Shoqeria’) eshte krijuar si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me NUS K 91721010 Q date 21.05.2009 me emertimin H&H Auditors Shpk. Ne daten 19/07/2010 shoqeria ka ndryshuar emrin ne BAKER TILLY ALBANIA shpk. dhe adresen e selise se saj.

Objekti kryesor i veprimtarise se shoqerise eshte sherbime auditimi ligjor, keshillime ne fushen e tatim taksave, mbajtje kontabiliteti etj. Me 31 Dhjetor 2013 shoqeria kishte 7 te punesuar (31 Dhjetor 2012: 6 te punesuar). Adresa e shoqerise eshte Rr. Themistokli Germenji, Nr. 2 Pallati Ambasador 1, kati i 3-te, Tirane. Shoqeria eshte regjistruar si person juridik ne sektorin e biznesit te madh te rrethin Tirane me NIPT K 91721010 Q.

Pasqyrat financiare te shoqerise per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013 jane miratuar nga Administratori i shoqerise me 28 Mars 2014.

## **2. BAZAT E PREGATITJES SE PASQYRAVE FINANCIARE**

### **a. Bazat e pregatitjes**

Pasqyrat financiare individuale jane pergatitur bazuar ne Standardet Kombetare te Kontabilitetit (SKK), te aplikueshme per pasqyrat financiare qe mbulojne periudhat duke filluar nga 1 Janar 2009.

### **b. Bazat e matjes**

Pasqyrat financiare jane pergatitur bazuar ne koston historike

### **c. Monedha funksionale dhe raportuese**

Pasqyrat financiare paraqiten ne Lek, e cila eshte monedha funksionale per Shoqerine.

### **d. Aktivet afatgjata materiale dhe jomateriale**

#### *(i) Njohja dhe matja*

Te gjitha aktivet afat-gjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvleresimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja perfshin shpenzime te cilat lidhen drejtperdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve te vetë-ndertuara perfshin koston e materialeve dhe punes direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes si në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në “Ndërtim në proces” dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentet më të mëdhenj) të aktiveve afat-gjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur, dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave.

## **2. BAZAT E PERGATITJES SE PASQYRAVE FINANCIARE (VAZHDIM)**

### *(ii) Kostot e mëpasshme*

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afat-gjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

### *(iii) Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën lineare apo zbritëse të amortizimit, mbi jeten e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit. Toka nuk amortizohet.

Normat e amortizimit per periudhën aktuale jane si më poshtë:

<b>Kategoria</b>	<b>Metoda e amortizimit</b>	<b>Norma e amortizimit</b>
Makineri dhe pajisje	Mbi vlerën kontabël neto	20%
Mobilje dhe orendi	Mbi vlerën kontabël neto	20%
Pajisje informatike	Mbi vlerën kontabël neto	25%
Mjete transporti	Mbi vlerën kontabël neto	20%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në cdo datë raportimi.

Aktivitetet afatgjata jomateriale njihen atehere kur eshte e mundur qe te perfitime ekonomike do te sigurohen ne te ardhmen ne lidhje me keto aktive dhe kostoja e tyre mund te matet ne menyre te besueshme. Ato amortizohen ne menyre lineare me norme vjetore 15%.

### **e. Llogarite e arketueshme dhe llogari te pagueshme**

Llogaritë e arketueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arketueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arketueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

### **f. Paraja dhe ekuivalentet e parase**

Paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat në Lek dhe në monedha të huaja. Për qëllimin e pasqyrës së flukseve monetare, paraja dhe ekuivalentet e saj përfshijnë depozita pa afat ose me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.



## **2. BAZAT E PERGATITJES SE PASQYRAVE FINANCIARE (VAZHDIM)**

### **g. Transaksione ne monedhe te huaj**

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Asetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare si dhe parapagimet në lidhje me AAM për t'u blerë në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset zyrtare të këmbimit për monedhat kryesore të përdorura në konvertimin e zërave të bilancit në monedhë të huaj ishin si më poshtë (në Lek):

	<u>31 Dhjetor 2013</u>	<u>31 Dhjetor 2012</u>
1 EUR	140,20	139,59
1 USD	101,86	105,85

### **h. Te ardhurat**

Të ardhurat njihen në masën që është e mundshme që përfitimet e ardhshme ekonomike do ti vijnë kompanisë dhe këto përfitime mund të maten në mënyrë të besueshme. Shpenzimet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur ato kryhen. Të ardhurat dhe shpenzimet regjistrohen në pasqyrat financiare të periudhës të cilës i përkasin.

### **i. Tatim fitimi**

Tatimi mbi fitimin është llogaritur në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi për tatimin mbi fitimin për periudhën e mbyllur më 31 Dhjetor 2013. Tatimi mbi fitimin përfshin tërësisht tatimin mbi fitimin e llogaritur për periudhën kontabël. Tatimi aktual mbi fitimin llogaritet si 10% e fitimit të tatueshëm të përcaktuar në legjislacionin e kontabilitetit dhe legjislacionin tatimor në Shqipëri për vitin 2013 (2012: 10%)

### **j. Biznesi ne vijimesi**

Pasqyrat financiare sipas legjislacionit janë përgatitur sipas parimit të vijimesise, i cili parashikon realizimin e aktiveve dhe shlyerjen e detyrimeve gjatë ecuresise normale të biznesit.

### **k. Krahasueshmeria**

Informacioni krahasues paraqitet në mënyrë të vazhdueshme, duke aplikuar politikat kontabël të Shoqërisë dhe duke u bazuar në modelin e pasqyrave financiare sipas sistemit kontabël Shqiptar.

**3. MJETE MONETARE**

	<u>2013</u>	<u>2012</u>
Arka	-	34.753
Banka	4.481.945	111.946
	<u><b>4.481.945</b></u>	<u><b>146.699</b></u>

**4. KLIENTE DHE TE TJERA KERKESA TE ARKETUESHME**

	<u>2013</u>	<u>2012</u>
Kliente	3.548.081	2.844.866
Tatim fitimi	72.511	71.700
Shpenzime te shtyra	530.910	553.156
Te tjera	129.100	310.261
	<u><b>4.280.602</b></u>	<u><b>3.779.983</b></u>

**5. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE**

	Mjete transporti	Paisje Zyre	Paisje Informatike	Totali
<i><b>Kosto</b></i>				
Gjendje ne 01.01.2012	2.000.000	13.416	92.237	2.105.653
Shtesa	-	7.125	28.500	35.625
Gjendje ne 31.12.2012	2.000.000	20.541	120.737	2.141.278
Shtesa	-	64.200	26.500	90.700
<b>Gjendje ne 31.12.2013</b>	<u><b>2.000.000</b></u>	<u><b>84.741</b></u>	<u><b>147.237</b></u>	<u><b>2.231.978</b></u>
<i><b>Amortizimi</b></i>				
Gjendje ne 01.01.2012	966.181	3.465	19.619	989.265
Shpenzimi per vitin 2012	206.764	2.228	19.342	228.334
Gjendje ne 31.12.2012	1.172.945	5.693	38.961	1.217.599
Shpenzimi per vitin 2013	165.412	8.521	22.124	196.058
<b>Gjendje ne 31.12.2013</b>	<u><b>1.338.357</b></u>	<u><b>14.214</b></u>	<u><b>61.085</b></u>	<u><b>1.413.657</b></u>
<i><b>Vlera e mbetur</b></i>				
Gjendje ne 31.12.2012	827.055	14.848	81.776	923.679
<b>Gjendje ne 31.12.2013</b>	<u><b>661.643</b></u>	<u><b>70.527</b></u>	<u><b>86.152</b></u>	<u><b>818.322</b></u>

**6. AKTIVE AFATGJATA JOMATERIALE**

	<b>Te drejta dhe licensa</b>	<b>Totali</b>
<i>Kosto</i>		
Gjendje ne 01.01.2012	215.973	215.973
Shtesa	-	-
Gjendje ne 31.12.2012	215.973	215.973
Shtesa	-	-
<b>Gjendje ne 31.12.2013</b>	<b>215.973</b>	<b>215.973</b>
<i>Amortizimi</i>		
Gjendje ne 01.01.2012	44.733	44.733
Shpenzimi per vitin 2012	32.396	32.396
Gjendje ne 31.12.2012	77.129	77.129
Shpenzimi per vitin 2013	32.396	32.396
<b>Gjendje ne 31.12.2013</b>	<b>109.525</b>	<b>109.525</b>
<i>Vlera e mbetur</i>		
Gjendje ne 31.12.2012	138.844	138.844
<b>Gjendje ne 31.12.2013</b>	<b>106.448</b>	<b>106.448</b>

**7. FURNITORE DHE DETYRIME TE TJERA**

	<b>2013</b>	<b>2012</b>
Detyrime ndaj punonjesve	4.697.533	631.438
Dividente per tu paguar	538.131	1.554.498
Furnitore	16.440	18.500
Tatim mbi te ardhurat personale	143.000	75.700
TVSH	122.087	200.211
Detyrime per sigurime shoqerore e shendetsore	92.708	84.800
Detyrime ndaj ortakeve	276.189	618.616
Tatim ne burim	7.015	13.981
Shpenzime te llogaritura	17.064	9.699
	<b>5.910.167</b>	<b>3.207.443</b>

**8. TE DREJAT DHE DETYRIME SI PERFAQESUES TATIMOR**

Keto llogari kane lidhje me aktivitetin si perfaqesues tatimor i shoqerise Grimshaw Architects LLP – UK per sherbimet qe kjo shoqeri i ofron Bashkise te Tiranës per projektin e bulevardit te lumit te Tiranës. Bashkia e Tiranës ka nje detyrim prej 8.742.864 LEK ne lidhje me vleren e TVSh-s se faturave te leshuara nga perfaqesuesi tatimor, dhe nga ana tjeter Grimshaw Architects LLP ka dhene nje paradhenie shoqerise Baker Tilly Albania prej 10.913.760 LEK per te financuar pagesen e detyrimeve te TVSh-s ndaj autoriteteve tatimore.

**9. TE ARDHURA NGA SHERBIMET**

	<b>2013</b>	<b>2012</b>
Sherbime auditimi	2.941.608	3.261.007
Sherbime te tjera te dhenies se sigurise	3.069.943	1.004.984
Sherbime tatimore	927.338	1.768.273
Sherbime kontabiliteti	5.936.436	2.671.619
Te tjera sherbime keshillimi	2.758.041	5.667.206
	<b>15.633.366</b>	<b>14.373.089</b>

**10. SHPENZIMER PER PERSONELIN**

	<b>2013</b>	<b>2012</b>
Paga dhe shperblime	10.513.000	9.341.176
Sigurime shoqerore e shendetsore	629.582	587.189
	<b>11.142.582</b>	<b>9.928.365</b>

**11. SHPENZIME ADMINISTRATIVE DHE TE TJERA**

	<b>2013</b>	<b>2012</b>
Qira zyre	1.121.296	1.669.586
Kuota anetaresimi (IEKA, BTI)	1.258.690	632.300
Shpenzime per automjetin	71.590	202.337
Udhetime e dieta	202.704	332.235
Shpenzime postate dhe telekomunikimi	250.358	173.902
Taksa vendore	25.120	35.240
Penalitete e gjoba	44	26.600
Te tjera	822.604	359.979
	<b>3.752.406</b>	<b>3.432.179</b>

**12. SHPENZIMI PER TATIM FITIMIN**

Bazuar në legjislacionin Shqiptar, norma e tatimit mbi fitimin është 10% për vitin 2013 (2012: 10%).

Deklaratat tatimore dorëzohen çdo vit por të ardhurat dhe shpenzimet e deklaruara për qëllime tatimi konsiderohen vetëdeklarime deri në momentin që autoritetet tatimore shqyrtojnë deklaratat dhe regjistrimet e tatimpaguesit dhe lëshojnë vlerësimin final. Ligjet dhe rregullat tatimore Shqiptare janë objekt interpretimi nga autoritetet tatimore. Në vitin 2013 Shoqëria ka rezultuar me një fitim kontabël dhe fiskal (2012: fitim kontabel dhe fiskal) si me poshte:

**12. SHPENZIMI PER TATIM FITIMI (VAZHDIM)**

	<u>2013</u>	<u>2012</u>
Fitimi para tatimit	518.974	723.113
<b>Shpenzime te panjohura</b>		
Gjoha	44	26.600
Shpenzime perfaqesimi	92.900	113.650
Sherbime nga jo rezidente	325.845	-
Te tjera	33.370	79.768
<b>Fitimi Tatimor</b>	<b>971.133</b>	<b>943.041</b>
<b>Tatim Fitimi</b>	<b><u>97.113</u></b>	<b><u>94.304</u></b>

**13. PARAPAGIM TATIM FITIMI**

	<u>2013</u>	<u>2012</u>
Gjendje ne fillim	71.700	4.524
Paguar gjate vitit	97.924	161.480
Tatim fitimi i vitit ushtrimor	(97.113)	(94.304)
<b>Parapagim/(Detyrim) ne fund</b>	<b><u>72.511</u></b>	<b><u>71.700</u></b>

**14. TVSH**

	<u>2013</u>	<u>2012</u>
Shitje te perjashtuara	531.521	1.010.571
Shitje te tatueshme (rubrika 11)	16.558.182	14.427.118
-Autofatura	(1.456.337)	(1.064.600)
<b>Totali i te ardhurave sipas bilancit</b>	<b><u>15.633.366</u></b>	<b><u>14.373.089</u></b>

	<u>2013</u>	<u>2012</u>
TVSH e llogaritur (rubrika 12)	3.311.636	2.885.423
TVSH i zbritshem autofatura (rubrika 17)	(291.267)	(212.920)
TVSH i zbritshem blerje (rubrika 17)	(77.343)	(42.226)
TVSH per tu paguar (rubrika 25)	2.943.026	2.630.277
TVSH e paguar gjate vitit ushtrimor	(2.820.939)	(2.430.066)
<b>Detyrime tatimore per TVSH-n</b>	<b><u>122.087</u></b>	<b><u>200.211</u></b>

**15. NGJARJE PAS MBYLLJES SE VITIT USHTRIMOR**

Nuk ka asnje ngjarje te rrendesishme pas mbylljes se vitit ushtrimor qe te kerkoje korrigjime apo pershkrime ne keto pasqyra financiare.